



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 44/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.01.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

**Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Gamma” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-72666-09-22-2020, me objekt: “*Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH*”, me fond limit 8.617.550 (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.11.2020, nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.”

**Ankimues:** “Krijon” sh.p.k.  
Rruga e Elbasanit, Nr.57, Çollak, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë  
Rruga “Qamil Guranjaku”, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Vepërtarisë së Institucionit të Komisionit të*

*Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.09.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-72666-09-22-2020, me objekt: “*Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH*”, me fond limit 8.617.550 (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.11.2020, nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

II.2. Në datën 18.11.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në

datë 10.12.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Gamma” sh.p.k. 6.969.908,13 lekë, kualifikuar
2. “Krijon” sh.p.k. 8.375.415 lekë, kualifikuar
3. “Isometric” sh.p.k. Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.4. Në datën 16.12.2020 operatori ekonomik “Krijon” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Gamma” sh.p.k., me arsyetimin si më poshtë vijon:

[...]

*Kemi marre pjese ne tenderin e zhvilluar date: 18.11.2020, klasifikimi i tenderit eshte shpallur ne date: 10.12.2020 ne APP, oferta jone nuk eshte refuzuar.*

*1.Veme ne dukje se vleresimi i ofertave nuk eshte bere me shumatoren e cmimeve per njesi por me vleren e pritshme te kontrates pra eshte shkelur kriteri i vleresimit 4.2 a) e paraqitur ne DST. Kjo kerkese bazohet edhe ne Udhezimin me numer 6 e dates 16.01.2018.*

*2. Pretendojme qe nuk eshte kryer vleresimi i sakte teknik i ofertave. Kompania konkurrenente Gamma shpk ka ofertuar disa artikuj qe nuk plotesojne specifikimet teknike te kerkuara ne DST. Gamma shpk eshte distributore e kompanise italiane Titolchimica per produktet "reagente". Nga verifikimi i katalogut zyrtar te kompanise prodhuese Titolchimica, te publikuar ne website [www.titolchimica.it](http://www.titolchimica.it) na rezulton se artikujt me numer rendor ne DST 1, 4, 9, 10, 11, 12, 13, 17, 18, 19, 21, 28, 30, 51 nuk jane reagent analitike sic kerkohet ne DST (nuk jane me pasterti P.A. por jane kategori me e ulet e pastertise - purissimo). Ne faqen 3 te ketij katalogu (bashkengjitur kesaj ankese) percaktohen sakte tre kategorite e pastertise se reagenteve - i paster, shume i paster dhe reagent per analize P.A. (per analize). Titolchimica nuk prodhon dhe nuk permban ne katalogun e saj artikujt e mesiperm ne graden e pastertise P.A. (sic kerkohet ne specifikimet teknike ne DST). Kjo vertetohet ne faqet e ekstraktuara nga katalogu zyrtar i kesaj kompanie, bashkengjitur ankeses sone. Veme ne dukje se reagentet me grade pastertie "purissimo- shume te paster" kane cmime 20 - 30 % me te uleta se reagentet P.A. Si rezultat i ketij fakti oferta ekonomike e kompanise Gamma shpk rezulton me e ulet.*

*3. Ne baze te kerkimit qe kemi bere ne ẽbsitin zyrtar te kompanise Titolchimica na rezulton qe artikujt me numer rendor ne DST 14, 15, 16, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 54, 57 nuk figurojne ne katalogun e publikuar, rrjedhimisht rezulton qe keto artikuj nuk prodhohen nga kjo kompani. Ne kuader te ketij informacioni ju sjellim ne vemendje se ne baze te ligjit per prokurimin publik neni 47, AK ka te drejte te skualifikoje cdo kandidat ose ofertues qe paraqet te dhena te rreme per qellime kualifikimi.*

*Kerkojme rivleresimin e dokumentacionit teknik te paraqitur nga kompania Gamma shpk nga specialiste me profesion kimist si dhe skualifikimin e ofertes se kesaj kompanie per mospermbushje te kriterave teknike te kerkuara ne DST. Kerkojme te verifikohet perputhja e katalogeve te paraqitur nga Gamma shpk per artikujt me numer rendor ne DST 14, 15, 16, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 54, 57, me katalogun zyrtar te kompanise Titolchimica publikuar ne website te kesaj kompanie.*

II.5. Referuar informacionit dorëzuar pranë KPP nga autoriteti kontraktor, konstatohet se ky i fundit me anë të shkresës nr.6725/4 prot, datë 22.12.2020, me objekt “Kthim përgjigje formularit të ankesës të administruar pranë autoritetit kontraktor me nr.6725, datë 16.12.2020 nga OE “Krijon” sh.p.k.”, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Krijon” sh.p.k., duke e refuzuar. Operatori ekonomik ankimes, në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, deklaroi se ka marrë dëgjime në lidhje me kthim përgjigjen e ankesës së tij, nga autoriteti kontraktor, më anë të postës elektronike (email), në datë 22.12.2020. Konkretisht autoriteti kontraktor ka argumentuar si më poshtë:

[...]

*Ne lidhje me kërkesat e subjektit ankues, Anetaret e Komisionit të Shqyrtimit të Ankeses (KSHA), referuar dhe specializimeve perkatese, argumentojne si me poshte vijon:*

*Vleresimi dhe gjykimi i KSHA*

*Ne pergjigje te Formularit te Ankeses se shoqerise tuaj, te administruar me nr.6725 prot., date 16.12.2020, ne lidhje me vleresimin e procedures se prokurimit "Procedure e hapur- Marreveshje Kuader me nje operator ekonornike, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara" - me afat te marreveshjes kuader 12 muaj, me objekt: me objekt: "Blerje Kite dhe Reagente, per nevojat e NJVKSH", per mbulimin e nevojave te NJVKSH per 12 muaj, ku Fondi limit i Marreveshjes Kuader (Vlera e Pritshme) eshte: Vlere e pritshme e kontratave qe mund te lidhen gjate MK: 8'617'550 (tete milion e gjashteqind e shtatembedhete mije e peseqind e pesedhete) Leke pa TVSH dhe Shumatore Cmimi per Njese: 330.185,03 (treqind e tridhete mije e njeqind e tetedhete e pese presje zero tre) Leke me TVSH, vene ne dispozicion nga buxheti i shtetit, anetaret e Komisionit te Shqyrtimit te Ankeses (KSHA), ne mbeshtetje dhe ne zbatim te Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914 date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" te ndryshuar, si dhe referuar kriterëve për kualifikim/ specifikimeve teknike te percaktuara ne Dokumentet Standarde te Tenderit (DST) shqyrtoi ankesen e paraqitur, si me poshte vijon:*

*1. Vleresimi i ofertave eshte bere bazuar ne piken 5.3 te Udhhezimit te Agjencise se Prokurimit Publik nr. 6 date 16.01.2018 "Per perdorimin e marreveshjes kuader dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar ku percaktohet se: "5.3 Ne rast se autoriteti kontraktor e ka objektivisht te pamundur te percaktoje sasine qe do te prokurohet, atehere do te vleresoje oferten/ofertat fituese duke u bazuar ne cmimin per njese. Kjo, metode vleresimi nuk do te perdoret nga autoritetet kontraktore kur sasite jane te llogaritshme ne baze vjetore, sipas eksperiences se meparshme, dhe kur marreveshja kuader perdoret per prokurimin e mallrave dhe sherbimeve te vazhdueshme. Ne kete rast, cmimi i ulet do te vleresohet me vleren totale me te ulet te ofruar".*

*Ne rastin konkret sasite e mallrave te prokuruarra jane llogaritur ne baze vjetore dhe prokurimi i mallrave - objekt prokurimi jane te vazhdueshme. Per me teper qe oferta juaj edhe ne rast te shumatores se cmimeve per njese nuk klasifikohet ne vend te pare. Sa me siper ankesa juaj per kete pike nuk qendron.*

*2. Ne ankesen dorezuar prane Autoritetit Kontraktor pretendoni qe O.E. tjetër konkurrues "Gamma" shpk ka ofruar disa artikuj qe nuk plotesojne specifikimet teknike te kerkuara ne DST dhe se ne ëbsiten zyrtar te kompanise Titolchimica nuk rezultojne artikujt me numer rendor ne DST 14, 15, 16, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 54, 57 ne katalogun e publikuar.*

*Per sa me siper, neni 46, pika 1 e LPP parashikon se: "1. Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e*

*meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese:*

*a) kualifikimi profesional: cdo operatori ekonomik i kerkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore, per veprimtarite e kerkuara dhe per te cilat do te lidhet kontrata;*

*b) aftesia teknike: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates;*

*c) gjendja ekonomike e financiare: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kapacitetet ekonomike e financiare per te permbushur kontraten, me ane te deklarave bankare ose, kur nevojitet, nepermjet vertetimit per sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes se bilanceve financiare ose te pjeseve te shkeputura nga bilancet, nje deklarate te xhiros se pergjithshme te shoqerise dhe, ne rast nevoje, te xhiros se realizuar nga veprimtarite e ngjashme me objektin e kontrates qe do te prokurohet per nje periudhe deri ne 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion eshte i mundur;*

*ç) kapacitetet ligjore: operatoret ekonomike vertetojne se ata kane zotesi juridike per te lidhur kontrata prokurimi ose, ne rastet e bashkimit te shoqerive, vertetojne se i gezojne keto aftesi ne kohen e lidhjes se kontrates ".*

*kurse neni 53, pika 4 e LPP parashikon se:*

*"3. Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji ".*

*Nga verifikimi i dokumentacionit te ofertes se O.E. "Gamma" shpk rezulton se oferta e tij eshte oferte me dokumentacion te plote, te rregullt dhe qe ploteson te gjitha kriteret e kualifikimit si dhe permbush te gjitha specifikimet teknike te kerkuara ne DT.*

*Ne katalogun e prodhuesit Titlchimica srl thuhet fjale per fjale se grada e pastertise puro, purissimo dhe P.A jane te gjitha qe perdoren per analizat laboratorike tradicionale dhe eshte % ajo qe e diferencon pastertine. Perqindjet e pastertise se ofruara nga O.E. "Gamma" shpk jane ne perputhje te plote me ate qe eshte kerkuar ne DT. Sa me siper ankesa juaj edhe per kete pike nuk qendron.*

*Ne kete kuader, per sa eshte argumentuar me siper, si dhe ne kuader te frymes se transparences te cilen legjislatori e synon nepermjet legjislacionit te prokurimit publik dhe akteve nenligjore per zbatim te tij, KSHA ne respektim te detyrimeve qe burojne nga dispozitat e ligjit nr. 9643 dt. 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar si dhe VKM nr. 914/2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" te ndryshuar, ka arritur ne, Konkluzionin:*

*-Të mos pranojë pretendimet e ngritura nga OE "Krijon" sh.p.k., në ankesën e administruar pranë AK NJVKSH Tiranë me nr. 6725 prot., datë 16.12.2020*

**II.6. Në datën 29.12.2020 operatori ekonomik "Krijon" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor. Konkretisht operatori ekonomik ankimes pretendon:**

*[...]*

Ne datën 22.12.2020, ora 22:18 me email AK ka kthyer nie pergjigje pa numer protokolli dhe date dhe ne pergjigjen e tii AK na e ka refuzuar ankesen duke mos marre parasysh asgje.

Per kete arsye iu drejtohem si organi me i larte i prokurimeve duke parashtruar argumentat si me poshte per ceshtjet e ankimuar ne AK:

1-Veme ne dukje se vleresimi i ofertave nuk eshte bere me shumatoren e cmimeve per njesi por me vleren e pritshme te kontrates pra eshte shkelur kriteri i vleresimit 4.2 a) e paraqitur ne DST. Kjo kerkese bazohet edhe ne Udhezimin me numer 6 e dates 16.01.2018

- AK nuk e ka marre parasysh kete pike te ankeses dhe nuk ka publikuar klasifikimin e ri sipas kriterit te parashikuar ne DST.

2- Pretendojme qe nuk eshte kryer vleresimi i sakte teknik i ofertave. Kompania konkurrenente Gamma shpk ka ofertuar disa artikuj qe nuk plotesojne specifikimet teknike te kerkuara ne DST. Gamma shpk eshte distributore e kompanise italiane Titolchimica per produktet "reagente". Nga verifikimi i katalogut zyrtar te kompanise prodhuese Titolchimica, te publikuar ne ẽbsite ẽẽẽ.titolchimica.it na rezulton se artikujt me numer rendor ne DST 1, 4, 9, 10, 11, 12, 13, 17, 18, 19, 21, 28, 30, 51 nuk jane reagent analitike sic kerkohet ne DST (nuk jane me pasterti P.A. por jane kategori me e ulet e pastertise - purissimo). Ne faqen 3 te ketij katalogu (bashkengjitur kesaj ankese) percaktohen sakte tre kategorite e pastertise se reagenteve - i paster, shume i paster dhe reagent per analize P.A. (per analize). Titolchimica nuk prodhon dhe nuk permban ne katalogun e saj artikujt e mesiperme ne graden e pastertise P.A. (sic kerkohet ne specifikimet teknike ne DST). Kjo vertetohet ne faqet e ekstraktuara nga katalogu zyrtar i kesaj kompanie, bashkengjitur ankeses sone. Veme ne dukje se reagentet me grade pastertie "purissimo- shume te paster" kane cmime 20 - 30 % me te uleta te reagentet P.A. Si rezultat i ketij fakti oferta ekonomike e kompanise Gamma shpk rezulton me e ulet. -AK ka dhene nje pergjigje aspak profesionale per kete pike te ankeses, ngaterrojne perqendrimin e substances se kerkuar me pastertine e produktit (e cila ka te beje me nivelin e substancave ndohtese). Perqendrimi i substaces (reagentit) me pastertine e tij jane dy koncepte krejt te ndryshme qe nuk kane lidhje me njeri tjetrin. Nje reagent psh Etanoli (alkali etilik) perdoret ne laborator me perqendrim te ndryshme ne varesi te aplikimit p.sh. me perqendrim 96 % ose 99.9 %, por per secilin nga keto perqendrim mund te kemi cilesi (pasterti) te nivelit i paster, shume i paster apo reagent analitik P.A. Mendojme se personat qe kane pergatitur pergjigjen ose nuk jane kimiste, ose kane nje diplome kimie te pamerituar, ose mbrojne me dashje interesat e kompanise Gamma. Per ta sqaruar kete ceshtje per persona qe nuk kane njohuri te mira ne fushen e kimise jemi te detyruar te japim nje shembull. Rakia e kumbulles mund te jete 21 grade e zjere (distiluar) njehere por mund te jete 21 grade duke e zjere (distiluar) dyhere. Sigurisht e para ka me shume papasterti, ka shije te keqe dhe te jep dhimbje koke. Gjithashtu edhe kosto e saj eshte me e ulet. I njejti fenomen ndodh gjate pergatitjes se reagenteve, reagentet analitik per analize P.A. kalojne me shume shkalle pastrimi (distilimi apo procese te tjera kimike) ne raport me reagentet e kategorise "te paster" apo "shume te paster". Kjo con ne kosto me te larte te pergatitjes se reagenteve analitike P.A. Na vjen keq qe specialistet qe kane pergatitur specifikimet teknike kane kerkuar ne DST cilesine reagent analitik P.A. ndersa KVO nuk ben vleresim teknik dhe toleron kompanine Gamma duke shkelur kriteret e vleresimit te kesaj gare. Jemi te bindur 100% per argumentat tona teknike. Kerkojme verifikimin e kesaj ceshtje teknike nga specialiste kimiste te pavarur jashte institucionit p.sh nga profesore kimie te Universiteteve.

3-Ne baze te kerkimit qe kemi bere ne ẽbsitin zyrtar te kompanise Titolchimica na rezulton qe artikujt me numer rendor ne DST 14, 15, 16, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 54, 57, nuk figurojne

ne katalogun e publikuar, rrjedhimisht rezulton qe keto artikuj nuk prodhohen nga kjo kompani. Ne kuader te ketij informacioni ju sjellim ne vemendje se ne baze te ligjit per prokurimin publik neni 47, AK ka te drejte te skualifikoje cdo kandidat ose ofertues qe paraqet te dhena te rreme per qellime kualifikimi. AK nuk ka kryer verifikimet e kerkuara dhe nuk ka dhene argumenta ne pergjigjen e saj lidhur me kete pike te ankeses sone. Verifikimi mund te behej lehtesisht ne website [www.titolchimica.it/en/catalogu.es](http://www.titolchimica.it/en/catalogu.es). Ankesa jone per kete ceshtje eshte bazuar ne verifikimin e kryer ne katalogun perkates ne kete website. Kerkojme te verifikohet perputhja e katalogeve te paraqitur nga Gamma shpk per artikujt me numer rendor ne DST 14, 15, 16, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 54, 57, me katalogun zyrtar te kompanise Titolchimica publikuar ne website te kesaj kompanie. Gjykojme qe eshte e rendesise se vecante rivleresimi i dokumentacionit teknik te paraqitur nga shoqeria Gamma shpk.

II.7. N p rmjet shkres s nr. 173/1 prot., dat  24.12.2020, protokolluar me ton n n  dat n 24.12.2020,  sht  deponuar n  Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedur n e m sip rme t  prokurimit dhe trajtimin e ankes s s  operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit t  ankes s, dokumentacionit bashk ngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit t  autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Krijon” sh.p.k se “Veme ne dukje se vleresimi i ofertave nuk eshte bere me shumatoren e cmimeve per njesi por me vleren e pritshme te kontrates pra eshte shkelur kriteri i vleresimit 4.2 a) e paraqitur ne DST. Kjo kerkese bazohet edhe ne Udhezimin me numer 6 e dates 16.01.2018. AK nuk e ka marre parasysht kete pike te ankeses dhe nuk ka publikuar klasifikimin e ri sipas kriterit te parashikuar ne DST”, Komisioni i Prokurimit Publik v ren se:

III.1.1. N  “Njoftimin e kontrat s” t  dokumentave t  procedur s s  prokurimit objekt ankimi,  sht  p rcaktuar:

Seksioni 2. Objekti i kontrat s

2.1 Numri i referenc s s  procedur s: REF-72666-09-22-2020

2.2 Lloji i “Kontratave Publike p r Mallra”

Blerje	Qira	Leasing	Blerje me k�ste	Nj� kombinim i tyre
X	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2.3 Kontrat  n  baz  t  Marr veshjes Kuad r

Po	X	Jo	<input type="checkbox"/>
----	---	----	--------------------------

2.4 Lloji i Marreveshjes Kuad r

Me një Operator Ekonomik

Me disa operatorë ekonomikë

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po  Jo

Në Marrëveshjen Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloji Marrëveshje Kuadër.

Kjo lloj marrëveshje (Marrëveshje Kuadër me një OE me të gjitha kushtet e përcaktuara), e bazuar në nenin 35/1, pika 5 e LPP dhe 47, pika 1/a dhe pika 2 e RrPP, është zgjedhur për shkak të mundësisë së kufizuar të alternativave për kite dhe reagentë sipas specifikave të kërkuara nga AK. Lidhur me prokurimin e këtij objekti, janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të marrëveshjes kuadër për sa i përket artikujve, specifikimet e sakta teknike, kushtet e rëndësishme të lëvrimin si dhe sasinë e pritshme të kërkuara. Për sa i përket sasive që do të nevojiten, AK nuk është në gjendje të parashikojë me saktësi sasinë e nevojshme për çdo artikull. Është zgjedhur kjo procedurë për arsye të mbulimit të shërbimit me mallin e kërkuar gjatë gjithë kohës duke u nisur nga vetë specifika që ka AK (NJVKSH). Në një marrëveshje, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, lëvrimi i mallit nga disa operatore ekonomike (nëpërmjet procedurës së mini-konkurimit) nuk është i favorshëm pasi krijon vështirësi autoritetit kontraktor për furnizim me sasinë e kërkuar në kohën e duhur, çka do të shkaktoje kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të lëvrimin duke shkakuar vonesa në ofrimin e mallit ,dhe si rrjedhojë do të ndikonte në mënyrë direkte në shëndetin e pacientit. Lidhja e MK me një OE të vetëm si dhe me të gjitha kushtet e përcaktuara, do të shoqërohej me mirë-organizimin e procedurës për sigurimin e mallrave në kohë, sigurimin e një rezerve për mbulimin e nevojave të pacientëve si dhe furnizimin në kohën e kërkuar nga AK.

2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të përfundojë Marrëveshja Kuadër: 1 (një)  
(Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër).

2.6	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike .	Nuk do të ketë rihapje të konkursit. Kontratat do të lidhen sipas kërkesave të AK, me operatorin ekonomik më të suksesshëm, i cili do të ofrojë cmimin më të ulët për njësi për artikujt objekt prokurimi dhe vlerën e pritshme më të ulët.
-----	--	---

2.7 Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër: Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë

2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër



Nr	Artikulli	Përshkrimi	Sasia	Njësia	Shumatore Çmim për një njësi	VLERË PA TVSH	TVSH	VLERË ME TVSH
1	Acid Sulfurik	Reagent analitik me pastërti $\geq 95 - 98 \%$ , Acid, i lëngët, pa ngjyrë ose ngjyrë të lehtë të verdhë. Me aromë të fortë shpuese Emri sipas IUPAC*: Sulfuric acid Formula Kimike: $H_2SO_4$	2,50	Lit				
2*	NESSLE R	Reagent analitik, i lëngët, me ngjyrë të verdhë të lehtë i përdorur në përcaktimin e amoniakut dhe kripërave të tij. Emri sipas IUPAC: Potassium tetraiodomercurate (2) Formula Kimike: $K_2HgI_4$	12,50	Lit				
3*	DPD 1	Tableta për matjen e klorit të lirë me limit dedektimi 0.01 – 6 mg/l Emri sipas IUPAC: N, N – diethyl – p – phenylenediamine Formula Kimike: $C_6H_{16}N_2$	8.500 ,00	Tablet a				
4	Acid Fosforik	Reagent analitik me pastërti $\geq 85 \%$ , Acid, i lëngët, pa ngjyrë dhe pa aromë.	1,00	Lit				

		<i>Emri sipas IUPAC: Phosphoric acid Formula Kimike: H<sub>3</sub>PO<sub>4</sub></i>							
5	Ampula dioksid karboni	<i>Matje e gazeve në mënyrë manuale me anë të aparaturës Drage r.</i>	<i>Kufiri i matjes 100 – 3000 ppm</i>	10,00	Copë (Ampulë)				
		<i>Një kuti ka dhjetë ampula.</i>							
6	Ampula toluol	<i>Matje e gazeve në mënyrë manuale me anë të aparaturës Drage r.</i>	<i>Kufiri i matjes 50 – 400 ppm</i>	10,00	Copë (Ampulë)				
		<i>Një kuti ka dhjetë ampula.</i>							

7	Ampula ksilol	Matje e gazev e në mënyr ë manu ale me anë të apara tit Drage r.  Një kuti ka dhjetë ampul a.	Kufiri i matjes 50 – 400 ppm	10,00	Copë (Ampu lë)				
8	Ampula hidrikar bure aromati ke	Matje e gazev e në mënyr ë manu ale me anë të apara tit Drage r.  Një kuti ka dhjetë ampul a.	Kufiri i matjes 50 – 400 ppm	10,00	Copë (Ampu lë)				
9	Jodur Kaliumi	Reagent analitik me pastërti $\geq 99\%$ . Pluhur i bardhë, pa aromë.	500,0 0	Gram					

		<i>Emri sipas IUPAC: Potassium iodide Formula Kimike: KI</i>						
10	<i>Perman ganat Kaliumi</i>	<i>Reagent analitik me pastërti <math>\geq 99</math> %. Pluhur me ngjyrë të purpur të errët, pa aromë. Emri sipas IUPAC: Potassium manganate (VII) Formula Kimike: KMnO<sub>4</sub></i>	<i>1.000 ,00</i>	<i>Gram</i>				
11	<i>Fenol ftaleinë</i>	<i>Phenolphthaleine. Reagent analitik me pastërti <math>\geq 98</math> %. I përdorur si indikator pasi tretet në ethanol. Pluhuri i bardhë pa aromë. Emri sipas IUPAC: 3,3-Bis(4- hydroxyphenyl)-2- benzofuran-1(3H)- one Formula Kimike: C<sub>20</sub>H<sub>14</sub>O<sub>4</sub></i>	<i>200,0 0</i>	<i>Gram</i>				
12 *	<i>NEDA</i>	<i>Reagent analitik me pastërti <math>\geq 98</math> %. Pluhur i bardhë kristalin, pa aromë. I përdorur në përcaktimin e nitriteve dhe nitrateve. Emri sipas IUPAC: N-(1- Naphthyl)Ethylenedi amine Dihydrochloride Formula Kimike: C<sub>12</sub>H<sub>16</sub>N<sub>2</sub>Cl<sub>2</sub></i>	<i>25,00</i>	<i>Gram</i>				
13		<i>Muratic acid. Reagent analitik 37</i>	<i>2,50</i>	<i>Lit</i>				

	Acid klorhidrik	% Acid i lëngët, pa ngjyrë dhe me aromë të fortë shpuese. Emri sipas IUPAC: Hydrochloric acid Formula Kimike: HCl						
14 *	Acid oksalik	Acid oxalic. Reagent analitik me pastërti $\geq 99.5\%$ . Pluhur i bardhë, kristalin, pa aromë. Emri sipas IUPAC: Ethanedioic acid Formula Kimike: C <sub>2</sub> H <sub>2</sub> O <sub>4</sub>	500,00	Gram				
15	Alkool etilik	Reagent analitik me pastërti $\geq 99.5\%$ . I lëngët, pa ngjyrë me aromë karakteristike të alkoolit. Emri sipas IUPAC: Ethanol Formula Kimike: C <sub>2</sub> H <sub>6</sub> O	6,00	Lit				
16 *	Nitrat argjendi	Reagent analitik me pastërti $\geq 99.5\%$ . Patretshmëria në ujë max 50 ppm. Pluhur kristalin, me ngjyrë të bardhë. Emri sipas IUPAC: Silver nitrate Formula Kimike: AgNO <sub>3</sub>	100,00	Gram				
17	Sulfat argjendi	Reagent analitik me pastërti $\geq 98.5\%$ . Pluhur kristalin, me ngjyrë të bardhë. Emri sipas IUPAC: Silver sulfate Formula Kimike: Ag <sub>2</sub> SO <sub>4</sub>	450,00	Gram				

18	EDTA	<p><i>Ethylenediaminetetraacetic acid.</i>  <i>Reagent analitik me pastërti ≥ 99 %.</i>  <i>Pluhur i përbërë nga kristale pa ngjyrë.</i>  <i>Emri sipas IUPAC: 2,2',2'',2'''-(Ethane-1,2-diyldinitrilo)tetraacetic acid</i> Formula Kimike: <math>C_{10}H_{16}N_2O_8</math></p>	500,00	Gram			
19	Hidroksidi natriumi	<p><i>Reagent analitik me pastërti ≥ 98 %.</i>  <i>Substance bazike, inorganike. E përbërë nga copëza të bardha.</i>  <i>Emri sipas IUPAC: Sodium hydroxide</i> Formula Kimike: <math>NaOH</math></p>	1,00	Kg			
20	Hidroksidi natriumi	<p><i>Reagent analitik me përqëndrim 0.1 N.</i>  <i>Solucion i standartizuar me saktësi 0.2 %.</i>  <i>Emri sipas IUPAC: Sodium hydroxide</i> Formula Kimike: <math>NaOH</math></p>	3,00	Flakone (Copë)			
21*	Kripë Seigneti	<p><i>Reagent analitik me pastërti ≥ 99 %.</i>  <i>Pluhur i bardhë kristalin.</i>  <i>Emri sipas IUPAC: Sodium potassium L(+)-tartrate tetrahydrate</i> Formula Kimike: <math>KNaC_4H_4O_6 \cdot 4H_2O</math></p>	1,00	Kg			

22	Acetat plumbi	<p>Reagent analitik me pastërti <math>\geq 99\%</math>.  Pluhur i bardhë kristalin.  Emri sipas IUPAC:  Lead (II) acetate  Formula Kimike:  <math>Pb(C_2H_3O_2)_2</math></p>	1.000,00	Gram				
23	Eter petrol	<p>Solvent i lëngët pa ngjyrë me temperaturë vlimi 40 – 60 °C.  Emri sipas IUPAC:  Petroleum ether  Formula Kimike:  <math>C_6H_{14}</math></p>	8,00	Lit				
24 *	Difenil aminë	<p>Reagent analitik me pastërti <math>\geq 99\%</math>.  Pluhur me ngjyrë të bardhë në krem.  Emri sipas IUPAC:  Diphenylamine  Formula Kimike:  <math>C_{12}H_{11}N</math></p>	500,00	Gram				
25	Hidroksi d amoni	<p>Reagent analitik i përgatitur nga amoniaku i tretur në ujë me përqëndrim 28%. Lëng pa ngjyrë me aromë shpuese.  Emri sipas IUPAC:  Ammonium hydroxide  Formula Kimike:  <math>NH_4OH</math></p>	1,00	Lit				
26 *	Brucinë	<p>Reagent analitik me pastërti <math>\geq 98\%</math>.  Pluhur me ngjyrë të bardhë.  Emri sipas IUPAC:  2,3-dimethoxystrychnidi n-10-one</p>	500,00	Gram				

		<i>Formula Kimike:</i> $C_{23}H_{26}N_2O_4$						
27 *	<i>Furfurol</i>	<i>Reagent analitik me pastërti <math>\geq 98\%</math>. Lëng vajor pa ngjyrë. Emri sipas IUPAC: Furan-2-carbaldehyde Formula Kimike: <math>C_5H_4O_2</math></i>	1,00	<i>Lit</i>				
28	<i>Metil Oranzh</i>	<i>Reagent analitik me pastërti <math>\geq 99.9\%</math>. Indikator. Pluhur me ngjyrë të ndezur portokalli. Emri sipas IUPAC: Sodium 4-{{4-(dimethylamino)phenyl}diazonyl}benzenesulfonate Formula Kimike: <math>C_{14}H_{14}N_3NaO_3S</math></i>	300,0 0	<i>Gram</i>				
29 *	<i>Kromat kaliumi</i>	<i>Reagent analitik me pastërti <math>\geq 99.5\%</math>. Pluhur me ngjyrë të verdhë të ndezur. Emri sipas IUPAC: Potassium chromate Formula Kimike: <math>K_2CrO_4</math></i>	500,0 0	<i>Gram</i>				
30	<i>Klorofor m</i>	<i>Reagent analitik me pastërti <math>\geq 99\%</math> Solvent i lëngët pa ngjyrë. Emri sipas IUPAC: Trichloromethane Formula Kimike: <math>CHCl_3</math></i>	2,50	<i>Lit</i>				



31 *	Kite feçe gjak okult	Rapid test imunokromatografik ; Test i shpejtë imunokromatografik për zbulimin e gjak okult në feçe me limit dedektimi 50 ng Hemoglobine/ ml	400,00	Teste				
32	Kite feçe Helicobacter Pylori	Rapid test imunokromatografik ; Test i shpejtë për përcaktimin e Helicobacter Pylori në feçe shoqëruar me kontrollet. Ku kontrolli pozitiv të përmbajë antigen Helicobacter Pylori ( $\geq 1\mu\text{g/ml}$ ), $< 0.1\%$ $\text{NaN}_3$ . Me sensitivitet analitik 0.78 ng/ml	1.200,00	Teste				
33	Cryptosporidium + Giardia combi	Test për zbulimin e Giardia dhe Cryptosporidium. Me specifitet relativ për Giardia 98.5 % dhe Cryptosporidium 98.5 %. Me përgjigje të rezultatit për 15 min.	100,00	Teste				
34	Gonorrhoea	Rapid test/ Test i shpejtë për identifikimin e antigenit Gonorrhoea, shoqëruar me kontrollet. Me limit dedektimi për Neisseria gonorrhoeae $1 \times 10^5$ CFU/ml. Një kuti ka 25 teste.	1,00	Kuti				

35	<i>Nystatine</i>	<i>Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.</i>	2,00	<i>Flakon</i>				
36	<i>Econazole</i>	<i>Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.</i>	3,00	<i>Flakon</i>				
37	<i>Clotrimazole</i>	<i>Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.</i>	1,00	<i>Flakon</i>				
38	<i>Ketoconazole</i>	<i>Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.</i>	1,00	<i>Flakon</i>				
39	<i>Myconazole</i>	<i>Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.</i>	2,00	<i>Flakon</i>				
40	<i>Fluconazole</i>	<i>Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.</i>	1,00	<i>Flakon</i>				
41	<i>Amphotericin B</i>	<i>Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.</i>	1,00	<i>Flakon</i>				
42	<i>Itraconazole</i>	<i>Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.</i>	5,00	<i>Flakon</i>				
43	<i>Tuba për marrjen e gjakut me xhel heparine</i>	<i>Vakuteste</i>	#### #### #	<i>Copë</i>				
44	<i>Kriotuba</i>	<i>Për ruajtjen e serumeve</i>	1.000 ,00	<i>Copë</i>				
45 *	<i>HIV 1 dhe HIV2</i>	<i>Kasete. Rapid test/ Test i shpejte imunokromatografik për zbulimin e antitropave të HIV1 dhe HIV2 në gjak dhe serum.</i>	7.500 ,00	<i>Teste (Copë)</i>				
46	<i>HBSAG</i>	<i>Kasete. Rapid test/ Test i shpejtë imunokromatografik për përcaktimin e antigenit sipërfaqësor të Hepatitit B në serum ose plazma.</i>	3.720 ,00	<i>Teste (Copë)</i>				

47 *	AntiHCV	Kasete. Test i shpejtë imunokromatografik për zbulimin cilësor të antitropave të hepatitisit C në serum, plazëm ose gjak, me sensitivitet 99.3 % për HCV	1.220 ,00	Teste (Copë)				
48 *	Syphilis	Kasete. Test i shpejtë imunokromatografik për përcaktimin e Syphilis.	720,0 0	Copë				
49 *	Pepton universal	Pluhur, ngjyrë bezhë i përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike. Tretet mirë në ujë.	86,00	Kg				
50	Laktozë	Pluhur i bardhë, i përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike. Tretet mirë në ujë.	12,00	Kg				
51	NaCl	Reagent analitik me pastërti $\geq 99.5\%$	8,00	Kg				
52	$K_2HPO_4$	Dipotassium phosphate. Pluhur i bardhë. I përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike. Tretet mirë në ujë.	25,00	Kg				
53	$KH_2PO_4$	Monopotassium phosphate. Pluhur i bardhë. I përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike. Tretet mirë në ujë.	12,50	Kg				

54	Azid natriumi	Sodium azide, me formulë $\text{NaN}_3$ . Pluhur me pastërti $\geq 99.5\%$ . I përdorur në terrenet mikrobiologjike.	100,00	Gram				
55	Glukoze	Glucose. Sheqer, monosaxharid me formulë $\text{C}_6\text{H}_{12}\text{O}_6$ . I përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike.	1.000,00	Gram				
56	Ekstrakt majaje	Pluhur; I përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike.	500,00	Gram				
57	Chloram femikol	Chloramphenicol. Antibiotik i përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike. Me formulë: $\text{C}_{11}\text{H}_{12}\text{N}_2\text{O}_5$	0,20	Kg				
58	Endo agar	Terren për testet finale dhe konfirmuese të coliforms në ujë.	5,50	Kg				
59*	Blood agar	Terren bazë për përgatitjen e pjatave agar – gjak.	3,50	Kg				
60*	DC	Dezoksikolat citrate agar. I përdorur në përgatitjen e terreneve selektive për izolimin e bakteve enterike.	9,00	Kg				
61	Natrium hidrogjen selenit	Pluhur me formulë: $\text{HNaO}_3\text{Se}$ . I përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike	100,00	Gram				

		<i>selektive. Për izolimin e Salmonellës dhe Shigellës.</i>						
62	<i>Manit</i>	<i>I përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike.</i>	500,00	<i>Gram</i>				
63*	<i>Bile salt</i>	<i>I përdorur në përgatitjen e terreneve selektive.</i>	4,50	<i>Kg</i>				
64	<i>Penicilin</i>	<i>Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.</i>	20,00	<i>Flakon</i>				
65	<i>Ampicilin</i>	<i>Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.</i>	20,00	<i>Flakon</i>				
66	<i>Bactrin</i>	<i>Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.</i>	25,00	<i>Flakon</i>				
67	<i>Cefexim</i>	<i>Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.</i>	20,00	<i>Flakon</i>				
68	<i>Ceftazidim</i>	<i>Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.</i>	20,00	<i>Flakon</i>				

69	Augumentin	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.	20,00	Flakon				
70	Piperacilin	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.	20,00	Flakon				
71	Meropenem	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.	20,00	Flakon				
Shumatore çmimi për njësi pa TVSH		330 185,03						
TVSH		66 037,006						
Shumatore çmimi për njësi me TVSH		396 222,036						
Fond Limit Vlerë e pritshme pa TVSH				8 617 550				
TVSH					1 723 510,00			
Fond Limit Vlerë e pritshme me TVSH						10 341 060,00		

1. Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër është 8'617'550 (tetë milion e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH dhe 10'341'060 (dhjetë milion e treqind e dyzet e një mijë e gjashtëdhjetë) Lekë me TVSH
  2. Shumatorja e çmimeve njësi: 330.185,03 (treqind e tridhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë presje zero tre) Lekë me TVSH
  3. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit.
  4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH", për mbulimin e nevojave të NJVKSH për 12 muaj;
- 2.9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:  
Kohëzgjatja në muaj 12 □□□ ose ditë □□□□  
ose  
duke filluar nga □□/□□/□□□□ me përfundim në □□/□□/□□□□

2.9.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: 12 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër;

Kohëzgjatja në muaj: 12 ose ditë: □□□□ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër(jo më shumë se (4) vjet)

Ose duke filluar nga □□/□□/□□ (dd/mm/vvvv)

Përfunduar më □□/□□/□□ (dd/mm/vvvv)

2.10 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës/marrëveshjes kuadër: Pranë Njesisë Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

III.1.2. Ndërsa në pikën 4.2 në “Njoftimin e kontratës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është përcaktuar:

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët X

Shënim: Marrëveshja Kuadër do të lidhet sipas çmimit më të ulët për njësi (shumatorës së çmimeve) për artikujt objekt prokurimi të OE fitues. Ky çmim nuk duhet të kalojë fondin limit për njësi (shumatoren) të përcaktuar në këto Dokumente Tenderit. Vlera totale e pritshme nuk duhet të kalojë vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër (në total). Në rast të kundërt oferta refuzohet.

III.1.3. Në shtojcën 1 “Formulari i ofertës ekonomike” nga autoriteti kontraktor është parashikuar:

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

#### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit \_\_\_\_\_

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

\* \* \*

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
Çmimi Neto )					
TVSH (%)					

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ (kërkuar në dokumentat e tenderit)

III.1.4. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të paraqitura, bazuar në cmimin total të ofertave, pa tvsh, si vijon:

- |                        |                                   |
|------------------------|-----------------------------------|
| 1. “Gamma” sh.p.k.     | 6.969.908,13 lekë, kualifikuar    |
| 2. “Krijon” sh.p.k.    | 8.375.415 lekë, kualifikuar       |
| 3. “Isometric” sh.p.k. | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

III.1.5. Në nenin 35/1, pika 5 dhe 8 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Kur një marrëveshje kuadër arrihet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve dhe kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër. Për prokurimin e këtyre kontratave, autoriteti kontraktor komunikon me shkrim me operatorin palë në marrëveshjen kuadër, duke i kërkuar atij të plotësojë ofertën, në përputhje me kërkesat.” “Në çdo rast, marrëveshja kuadër zbatohet sipas përcaktimeve të parashikuara në rregullat e prokurimit publik.”

III.1.6. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 41, përcaktohet se: “Marrëveshje kuadër quhet një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve kontraktore dhe një apo më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasinë e parashikuara”.

Në nenin 45, pika 2 të këtyre rregullave përcaktohet se: “Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 55, të LPP-së. Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi”

Ndërsa në nenin 47, pika 1 dhe 2, po këtu, parashikohet se:

1. Marrëveshja kuadër mund të lidhet me:

a) një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara;

b) disa operatorë ekonomikë kur:

- të gjitha kushtet janë të përcaktuara;

- jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

2. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operatori ekonomik i kërkohet të



*përgatitë ofertën e tij vetëm në lidhje me kushtet për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër.*

III.1.7. Në Udhëzimin Nr.6, datë 16.01.2018, të Agjencisë së Prokurimit Publik (I ndryshuar), pika 5.3 parashikohet se:

*5.3 Në rast se autoriteti kontraktor e ka objektivisht të pamundur të përcaktojë sasinë që do të prokurohet, atëherë do të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi.*

*Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet kontraktore kur sasi të janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar.*

III.1.8. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.9. Në dokumentat e tenderit kjo kontratë është parashikuar të jetë kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër dhe përshkrimi i saj nga ana e autoritetit kontraktor është “*Kjo lloj marrëveshje (Marrëveshje Kuadër me një OE me të gjitha kushtet e përcaktuara), e bazuar në nenin 35/1, pika 5 e LPP dhe 47, pika 1/a dhe pika 2 e RrPP, është zgjedhur për shkak të mundësisë së kufizuar të alternativave për kite dhe reagentë sipas specifikave të kërkuara nga AK. Lidhur me prokurimin e këtij objekti, janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të marrëveshjes kuadër për sa i përket artikujve, specifikimet e sakta teknike, kushtet e rëndësishme të lëvrimin si dhe sasi të e pritshme të kërkuara. Për sa i përket sasive që do të nevojiten, AK nuk është në gjendje të parashikojë me saktësi sasi të e nevojshme për çdo artikull. Është zgjedhur kjo procedurë për arsye të mbulimit të shërbimit me mallin e kërkuar gjatë gjithë kohës duke u nisur nga vetë specifika që ka AK (NJVKSH). Në një marrëveshje, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, lëvrimi i mallit nga disa operatore ekonomike (nëpërmjet procedurës së mini-konkurimit) nuk është i favorshëm pasi krijon vështirësi autoritetit kontraktor për furnizim me sasinë e kërkuar në kohën e duhur, çka do të shkaktoje kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të lëvrimin duke shkaktuar vonesa në ofrimin e mallit ,dhe si rrjedhojë do të ndikonte në mënyrë direkte në shëndetin e pacientit. Lidhja e MK me një OE të vetëm si dhe me të gjitha kushtet e përcaktuara, do të shoqërohej me mirë-organizimin e procedurës për sigurimin e mallrave në kohë, sigurimin e një rezerve për mbulimin e nevojave të pacientëve si dhe furnizimin në kohën e kërkuar nga AK.”*

Ndërsa në pikën 4.2 të Njoftimit të kontratës parashikohet se “*Marrëveshja Kuadër do të lidhet sipas çmimit më të ulët për njësi (shumatorës së çmimeve) për artikujt objekt prokurimi të OE fitues. Ky çmim nuk duhet të kalojë fondin limit për njësi (shumatoren) të përcaktuar në këto Dokumente Tenderit. Vlera totale e pritshme nuk duhet të kalojë vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër (në total)”*.

Referuar sa më sipër KPP gjykon se në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar shprehimisht mënyrën e vlerësimit dhe të krahasimit të ofertave, dhe u bën me dije ofertuesve se ofertat e tyre do të paraqitet si shumatore e çmimeve për njësi, të përlllogaritur për cdo artikull, por gjithashtu autoriteti kontraktor ka kërkuar të paraqitet edhe vlera e pritshme e kontratës.

III.1.10. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues e autoriteti kontraktor si dhe nga verifikimi i bërë në SPE, rezulton se vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të paraqitura nga ofertuesit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, është bërë bazuar në çmimin total pa tvsh të ofertave të paraqitura nga subjektet pjesëmarrëse. Sa më sipër, KPP, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe argumentimet e sjella nga autoriteti kontraktor, konstaton se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, për secilin nga artikujt e kërkuar ka parashikuar sasinë e përafërt të kërkuar. Gjithashtu në shtojcën 1 Formularin e Ofertës Ekonomike, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që operatorët ekonomikë të ofertojnë duke paraqitur Çmimin për njësi dhe Çmimin në total.

Akoma më tej, referuar Udhëzimit Nr.6, datë 16.01.2018, të Agjencisë së Prokurimit Publik (I ndryshuar), pika 5.3 ku parashikohet se *“Në rast se autoriteti kontraktor e ka objektivisht të pamundur të përcaktojë sasinë që do të prokurohet, atëherë do të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi. Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet kontraktore kur sasi të janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar.”* Pra, në ato raste kur sasi të kërkuara janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme, atëherë autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kryejë vlerësimin e ofertave duke u bazuar në vlerën totale të tyre.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, vlerësimi i ofertave, i kryer nga KVO, referuar çmimit në total, nuk afekton rezultatin dhe renditjen përfundimtare të ofertave edhe nëse ky vlerësim do të kryhej bazuar në shumatoren e çmimin për njësi, pasi në rastin konkret operatori ekonomik ankimues, ka ofertuar çmimin për njësi më lart se operatori ekonomik për të cilin ka ngritur pretendime, kështu që rrjedhimisht rivlerësimi i kësaj procedure nuk do të sillte ndryshim në renditjen përfundimtare.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Krijon” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Gamma” sh.p.k. me argumentin se *“Pretendojme që nuk është kryer vlerësimi i sakte teknik i ofertave. Kompania konkurrenente Gamma shpk ka ofertuar disa artikuj që nuk plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara në DST. Gamma shpk është distributore e kompanisë italiane Titolchimica për produktet "reagente". Nga verifikimi i katalogut zyrtar të kompanisë prodhuese Titolchimica, të publikuar në website [www.titolchimica.it](http://www.titolchimica.it) na rezulton se artikujt me numer rendor në DST 1, 4, 9, 10, 11, 12, 13, 17, 18, 19, 21, 28, 30, 51 nuk janë reagent analitike sic kërkohej në DST (nuk janë me pastërti P.A. por janë kategori me e ulet e pastertise - purissimo). Në faqen 3 të këtij katalogu (bashkëngjitur kësaj ankese) përcaktohen sakte tre kategoritë e pastertise së reagenteve - i paster, shumë i paster dhe reagent për analizë P.A. (për analizë). Titolchimica nuk prodhon dhe nuk përmban në katalogun e saj artikujt e mesipër në gradën e pastertise P.A. (sic kërkohej në specifikimet teknike në DST). Kjo vërtetohet në faqet e ekstraktuara nga katalogu zyrtar i kësaj kompanie, bashkëngjitur ankësës sone. Vënie në dukje se reagentet me grade pastertie "purissimo- shumë të paster" kanë çmime 20 - 30 % më të ulëta të*

reagentet P.A. Si rezultat i ketij fakti oferta ekonomike e kompanise Gamma shpk rezulton me e ulet. -AK ka dhene nje pergjigje aspak profesionale per kete pike te ankeses, ngaterrojne perqendrimin e substanes se kerkuar me pastertine e produktit (e cila ka te beje me nivelin e substancave ndohtese). Perqendrimi i substanes (reagentit) me pastertine e tij jane dy koncepte krejt te ndryshme qe nuk kane lidhje me njeri tjetrin. Nje reagent psh Etanoli (alkali etilik) perdoret ne laborator me perqendrim te ndryshme ne varesi te aplikimit p.sh. me perqendrim 96 % ose 99.9 %, por per secilin nga keto perqendrim mund te kemi cilesi (pasterti) te nivelit i paster, shume i paster apo reagent analitik P.A. Mendojme se personat qe kane pergatitur pergjigjen ose nuk jane kimiste, ose kane nje diplome kimie te pamerituar, ose mbrojne me dashje interesat e kompanise Gamma. Per ta sqaruar kete ceshtje per persona qe nuk kane njohuri te mira ne fushen e kimise jemi te detyruar te japim nje shembull. Rakia e kumbulles mund te jete 21 grade e zjere (distiluar) njehere por mund te jete 21 grade duke e zjere (distiluar) dyhere. Sigurisht e para ka me shume papasterti, ka shije te keqe dhe te jep dhimbje koke. Gjithashtu edhe kosto e saj eshte me e ulet. I njejti fenomen ndodh gjate pergatitjes se reagenteve, reagentet analitik per analize P.A. kalojne me shume shkalle pastrimi (distilimi apo procese te tjera kimike) ne raport me reagentet e kategorise "te paster" apo "shume te paster". Kjo con ne kosto me te larte te pergatitjes se reagenteve analitike P.A. Na vjen keq qe specialistet qe kane pergatitur specifikimet teknike kane kerkuar ne DST cilesine reagent analitik P.A. ndersa KVO nuk ben vleresim teknik dhe toleron kompanine Gamma duke shkelur kriteret e vleresimit te kesaj gare. Jemi te bindur 100% per argumentat tona teknike. Kerkojme verifikimin e kesaj ceshtje teknike nga specialiste kimiste te pavarur jashte institucionit p.sh nga profesore kimie te Universiteteve. ", Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se,

III.2.1. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimes nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* për të gjithë kriterin në total, duke ngritur dyshime e hamendësime, nëse i plotëson specifikimet e vendosura në DST operatori ekonomik "Gamma" sh.p.k, i kualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.2.2. Vlen të theksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.2.3. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë.

Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kritereve.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të

këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.2.5. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efikasitetin e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatorit pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përsë vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrajnë pretendime a-priori duke iu referuar të gjithë specifikimeve teknike duke mos identifikuar asnjë element konkret, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se *“onus probandi incumbit actori”* se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjithë elementët proceduralë, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Konkretisht, neni 21 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar, parashikon se: *“Informacioni i administruar, sipas nenit 12 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave. Autoriteti kontraktues është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”*, ndërkohë në nenin 25 të tij parashikohet se *“Pa cenuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.”*

III.2.6. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.2.7. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Akoma më tej, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor nuk është përcaktuar apo vendosur ndonjë kërkesë në specifikimet teknike të reagentëve në lidhje me “niveli i pastërtisë PA”, ndaj paraqitja apo mosparaqitja e tij nuk mund të përbëjë shkak për kualifikimin/skualifikimin e një operatori ekonomik. Për pasojë, gjykojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentat e tenderit e, rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në rastin në shqyrtim, në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar “niveli i pastërtisë PA” për reagentët e përmendur nga operatori ekonomik ankimues, rrjedhimisht, autoriteti kontraktor nuk mund të vlerësojë mbi kritere të cilat nuk janë kërkuar nga ana e tij, në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Krijon” sh.p.k. nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Krijon” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Gamma” sh.p.k. me arsyetimin se “*Ne baze te kerkimit qe kemi bere ne websitin zyrtar te kompanise Titolchimica na rezulton qe artikujt me numer rendor ne DST 14, 15, 16, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 54, 57, nuk figurojne ne katalogun e publikuar, rrjedhimisht rezulton qe keto artikuj nuk prodhohen nga kjo kompani. Ne kuader te ketij informacioni ju sjellim ne vemendje se ne baze te ligjit per prokurimin publik neni 47, AK ka te drejte te skualifikoje cdo kandidat ose ofertues qe paraqet te dhena te rreme per qellime kualifikimi. AK nuk ka kryer verifikimet e kerkuara dhe nuk ka dhene argumenta ne pergjigjen e saj lidhur me kete pike te ankeses sone. Verifikimi mund te behej lehtesisht ne website www.titolchimica.it/en/catalogu.es. Ankesa jone per kete ceshtje eshte bazuar ne verifikimin e kryer ne katalogun perkates ne kete website. Kerkojme te verifikohet perputhja e katalogeve te paraqitur nga Gamma shpk per artikujt me numer rendor ne DST 14, 15, 16, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 54, 57, me katalogun zyrtar te kompanise Titolchimica publikuar ne website te kesaj kompanie*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, “*Kapaciteti teknik*”, pika 2.3/b/c/ç/d, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

b) *Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogë, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut qe përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nëse nuk janë ne gjuhen shqipe, te përkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun përkatës produktin (ose pjesët e produktit) qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te përcaktuar ne formularin e ofertës. Katalogët do pranohen vetëm ne forme elektronike nëpërmjet sistemit elektronik te prokurimit.*

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të lëshuar nga Prodhuesi / MAH / Distributori Zyrtar i Autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregtoje mallrat (materialet mjekësore) objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave;

ç) Kërkohet Autodeklaratë (Deklarate Konformiteti CE/DC) për mallrat (materialet mjekësore, kite, reagentë, konsumablet), nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EC, ose 98/79 EC, ose 2015/1535/EU, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet të certifikatave perkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti), origjinale, ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara, të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Ofertë Teknike, për artikujt e kërkuar (Sebashku me pjesët perberëse) në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet perkatëse për produktet.

III.3.2. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit, pika 2.3/ç e “Kapacitetit teknik”, është modifikuar si më poshtë:

Ne DST në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, germa ç) ndryshohet si më poshtë:

**ISHTE:**

ç) Kërkohet Autodeklaratë (Deklarate Konformiteti CE/DC) për mallrat (materialet mjekësore, kite, reagentë, konsumablet), nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EC, ose 98/79 EC, ose 2015/1535/EU, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet të certifikatave perkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti), origjinale, ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara, të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

**BËHET:**

ç) Kërkohet Autodeklaratë (Deklarate Konformiteti CE/DC) për mallrat (materialet mjekësore, kite, reagentë, konsumablet), nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EC, ose 98/79 EC, ose 2015/1535/EU, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet të certifikatave perkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose certifikatë FDA, origjinale, ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara, të vlefshme në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

III.3.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik “Gamma” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor, ka paraqitur:

- Autorizim prodhuesi lëshuar nga “Titolchimica” s.p.a në emër të operatorit ekonomik “Gamma” sh.p.k. për tregtimin e produkteve të prodhuara nga “Titolchimica” s.p.a, i perkthyer dhe i noterizuar.
- Deklaratë e prodhuesit “Titolchimica” s.p.a. në të cilën janë paraqitur produktet që ofron “Titolchimica” s.p.a., dhe ku deklarohe se këto produkte “janë prodhuar nën kontroll të

*kualitetit të lartë dhe produktet – i përshtatet kërkesave të EU për sigurinë, shëndetin ose ambientin, - I përshtatet legjislacionit të EU”, (i përkthyer dhe i noterizuar).*

- Ofertën teknike e plotësuar nga operatori ekonomik “Gamma” sh.p.k., në të cilën pasqyrohen Kodi i produktit, Produkti, Specifikimi, Kompania prodhuese, Shteti, Skadenca e mallit, Nr. i faqes së katalogut ku ndodhet produkti, Certifikimet.
- Katalogun e produkteve, të prodhuesit “Titolchimica” s.p.a.

III.3.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.3.5. Ndërsa në nenin 53/3 të të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.3.6. Në nënin 27, pika 6 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

*“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

*b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose*

*c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

III.3.7. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes se *“Ne baze te kerkimit qe kemi bere ne websitin zyrtar te kompanise Titolchimica na rezulton qe artikujt me numer rendor ne DST 14, 15, 16, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 54, 57, nuk figurojne ne katalogun e publikuar, rrjedhimisht rezulton qe keto artikuj nuk prodhohen nga kjo kompani”,* nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Gamma” sh.p.k. konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentin “Ofertë teknike” në të cilin për secilin nga produktet deklarohet Kodi i produktit, Produkti, Specifikimi, Kompania prodhuese, Shteti, Skadenca e mallit, Nr. i faqes së katalogut ku ndodhet produkti, Certifikimet; Dokumentin autorizim prodhuesi lëshuar nga shoqëria “Titolchimica” s.p.a., ku ky i fundit autorizon shoqërinë “Gamma” sh.p.k. për tregtimin e produkteve të prodhuara prej saj; Dokumentin deklaratë të prodhuesit “Titolchimica” s.p.a. në të cilën janë paraqitur dhe listuar produktet që ofron “Titolchimica” s.p.a., dhe ku deklarohet se këto produkte *“janë prodhuar nën kontroll të kualitetit të lartë dhe produktet – i përshtatet kërkesave të EU për sigurinë, shëndetin ose ambientin, - I përshtatet legjislacionit të EU”, (i përkthyer dhe i noterizuar);* Katalogun e produkteve, të prodhuesit “Titolchimica” s.p.a., në të cilin gjenden të

pasqyruara të gjitha produktet, për të cilat operatori ekonomik ankimues ngre pretendime se këto produkte nuk gjenden në katalogun e prodhuesit “Titolchimica” s.p.a. e si rrjedhojë nuk prodhohen nga ky i fundit.

III.3.8. Referuar sa më sipër, KPP nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Gamma” sh.p.k., konstatohet se ky i fundit, ka paraqitur katalog nga prodhuesi “Titolchimica” s.p.a., për të gjitha produktet (*artikujt me numër rendor ne DST 14, 15, 16, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 54, 57*) e përmendura nga operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij. Gjithashtu, nga verifikimi konstatohet se katalogu i mësipërm është i përkthyer, i noterizuar dhe në të janë markuar të gjitha produktet me numër rendor i cili korrespondon me numrin rendor të artikullit të përcaktuar në formularin e ofertës, duke plotësuar kështu të gjitha kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.3.9. Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se *“Në bazë të kërimit që kemi bërë në websitin zyrtar të kompanisë Titolchimica na rezulton që artikujt me numër rendor ne DST 14, 15, 16, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 54, 57, nuk figurojnë në katalogun e publikuar, rrjedhimisht rezulton që këto artikuj nuk prodhohen nga kjo kompani”*, KPP, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Gamma” sh.p.k., ndër të tjera konstatohet se ky i fundit ka paraqitur një deklaratë të prodhuesit “Titolchimica” s.p.a. në të cilën listohen produktet që ofron “Titolchimica” s.p.a., dokument në të cilin gjenden të gjitha produktet për të cilat ka ngritur pretendime operatori ekonomik ankimues. Sa më sipër, operatori ekonomik “Gamma” sh.p.k. me dokumentacionin e paraqitur vërteton se prodhuesi “Titolchimica” s.p.a. prodhon të gjitha produktet për të cilat operatori ekonomik ankimues ngre pretendime, duke plotësuar kështu kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Krijon” sh.p.k., për skualifikimin e operatorit ekonomik “Gamma” sh.p.k. nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të mos pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Krijon” sh.p.k. për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me nr. REF-72666-09-22-2020, me objekt: *“Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH”*, me fond limit 8.617.550 (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.11.2020, nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.



3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1819 Protokolli**

**Datë 29.12.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**